



Vlerësimi në shkallën primare dhe në shkallën sekondare I të shkollës popullore

Informacione për prindërit dhe personat me të drejtë edukimi për vlerësimin në shkallën primare dhe në shkallën sekondare I të shkollës popullore

Informacione për kopshtin e fëmijëve, për Basisstufe dhe për Cycle élémentaire gjenden në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim të kantonit Bernë: www.erz.be.ch

Pasqyra e lëndës

Vlerësimi i orientuar ndaj kompetencës	4
Vlerësimi i nxënësve dhe nxënësve është	4
Funksione të ndryshme të vlerësimit të nxënësve dhe nxënësve	5
Vendimet për karrierën shkollore	6
Procedura e kalimit nga shkalla primare në shkallën sekondare I	7
Shtojca:	
– Shtojca 1: Notat kanë këtë kuptim	9
– Shtojca 2: Forma e vlerësimit sipas shkallëve	10

Impressum

Botuesja

Erziehungsdirektion des Kantons Bern

Kontakt/Informacion

Erziehungsdirektion des Kantons Bern

Sulgeneckstrasse 70, 3005 Bern

031 633 85 11

akvb@erz.be.ch

2. Auflage Februar 2018

#826381v1

Të dashur prindër

Kjo broshurë informative ju jep informacione mbi vlerësimin dhe vendimet për karrierën shkollore të fëmijës suaj. Në qoftë se keni nevojë për informacione të mëtejshme, vizitoni faqen tonë të internetit www.erz.be.ch ose drejtohuni tek mësimdhënësi i klasës ose drejtorja e shkollës.

Ju e gjeni këtë broshurë informative edhe të përkthyer në gjuhë të ndryshme në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim të kantonit Bernë www.erz.be.ch

Drejtorja për Edukim

Vlerësimi i orientuar ndaj kompetencës

Në radhë të parë vlerësimi i shërben nxitjes dhe duhet të përjetohet nga fëmija juaj si mbështetje e të mësuarit të vet. Gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit mësuesit orientohen në kompetencat e Lehrplan 21.

Vlerësimi i nxënësve dhe nxënësve është ...

... i orientuar drejt nxitjes

Vlerësimet dhe përgjigjet nxitin të mësuarin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të të rinjve dhe tregojnë si duhet të fillohen hapat e tjera të të mësuarit.

... në përputhje me mësimin

Baza e çdo vlerësimi janë situatat e të mësuarit gjatë mësimin.

... transparent

Vlerësimet i informojnë prindërit në mënyrë të diferencuar dhe të kuptueshme mbi përparimet e të mësuarit dhe zhvillimin e vajzës ose djalit të tyre.

... i gjithanshëm

Në vlerësim përfshihen si kompetenca lëndore, ashtu edhe të tilla ndërdisiplinore.

Kompetenca lëndore fitohen në lëndë të ndryshme (gjermanisht, matematikë, muzikë, etj.). Kompetencat ndërdisiplinore luajnë një rol të rëndësishëm mbi lëndët, p.sh. pavarësia ose aftësia për të punuar në ekip. Në mësim kompetencat lëndore dhe ndërdisiplinore lidhen me njëra-tjetrën.

Funksiione të ndryshme të vlerësimit të nxënësve dhe nxënësve

Vlerësimi dhe shoqërimi i procesit mësimor

Detyra më e rëndësishme në mësim konsiston në atë, që procesi mësimor i fëmijës suaj të mbështetet me sukses. Për këtë nxënëset dhe nxënësit vëzhgohen rregullisht dhe sipas kriterëve të zgjedhura nga mësimdhënësit e tyre. Rezultatet e këtyre vëzhgimeve u shërbejnë mësimdhënësve që të organizojnë mësimin e tyre në mënyrë përkatëse dhe të japin sugjerime dhe informacione konkrete gjatë bisedave me prindërit.

Vlerësimi i gjendjes së të mësuarit

Pas pjesëve të mëdha të mësimit mësimdhënësit vlerësojnë me anë të produkteve, kontrolleve të të mësuarit dhe procesit të të mësuarit sa mirë nxënëset dhe nxënësit i kanë arritur objektivat e mësimin.

Objektivat e mësimin dhe kriteret u bëhen të njohura nxënësve dhe nxënësve në fillim të secencës së të mësuarit.

Vetëvlerësimi

Me vetëvlerësimet gjatë vitit shkollor nxënëset dhe nxënësit i vënë në veprim kompetencat e tyre lëndore dhe ndërdisiplinore. Ata mendojnë gjatë kësaj mbi të mësuarin e tyre dhe marrin vetë përgjegjësi për procesin e tyre të të mësuarit. Vetëvlerësimi zhvillohet në kuadrin e situatës së të mësuarit në çdo lëndë.

Biseda me prindërit

Ajo është një element kryesor për krijimin e besimit dhe bashkëpunimin midis shkollës dhe shtëpisë prindërore dhe zhvillohet një herë në vit. Biseda me prindërit e nxit kontaktin personal midis prindërve dhe mësimdhënësve dhe mundëson një krahasim midis vetëvlerësimit të nxënësve dhe nxënësve, vlerësimit të huaj nga mësimdhënësit si dhe vlerësimit nga këndvështrimi i prindërve. Biseda me prindërit i njeh dhe çmon arritjet e mira dhe sjelljet pozitive. Por gjithashtu është e mundshme që të flitet direkt për situata problematike dhe të lidhen marrëveshje të përbashkëta. Në rast të ngjarjeve të

veçanta ose me dëshirën e prindërve shkolla ofron biseda shtesë.

Protokoll mbi bisedën me prindërit

Temat e diskutuara shënohen me një kryq dhe plotësohen eventualisht me një fjalë niseje. Marrëveshje të përbashkëta me prindërit mund të protokollohen me pak fjalë. Nëse nuk ka nevojë për marrëveshje të përbashkëta, atëherë kjo fushë mbete bosh. Ky formular është pjesë e dosjes së dokumenteve.

Portfoli kompetenca personale dhe kompetenca kyçe

Kompetenca personale dhe kompetenca kyçe u përkasin kompetencave ndërdisiplinore. Vlerësimet e tyre pasqyrohen në fund të vitit të 7-të, 8-të dhe 9-të shkollor në një formular të veçantë. Edhe mësimdhënësit, edhe nxënëset dhe nxënësit japin një vlerësim.

Raporti mbi vlerësimin

Raporti mbi vlerësimin u jep nxënësve dhe nxënësve një përgjigje me shkrim mbi gjendjen e arritjeve të tyre në lëndët e ndryshme.

Nxënëset dhe nxënësit marrin një raport mbi vlerësimin.

Shkalla primare:

– Në fund të vitit të 2-të, 4-rt, 5-të dhe 6-të shkollor

Shkalla sekondare I

– Në fund të vitit të 7-të, 8-të dhe 9-të shkollor

Këto bazohen në vendimin sipas vlerësimit të mësimdhënësve dhe jo në llogaritjet e vlerave mesatare.

Vendimet për karrierën shkollore

Një vendim për karrierën shkollore bëhet në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm. Në qendër qëndron pyetja, në cilën klasë, në cilin tip shkollor ose nivel mund të nxitet nxënësja, nxënësi më mirë.

Vendime për karrierën shkollore kanë të bëjnë në mënyrë të veçantë me:

- kalimin në vitin tjetër shkollor;
- kapërcimin ose përsëritjen e një viti shkollor;
- caktimin për një klasë të veçantë ose kthimi nga një klasë e veçantë në një klasë të rregullt;
- caktimin, mbetjen ose ndërrimin në një tjetër tip shkollor ose në një lëndë të një niveli tjetër të shkollës sekondare I;
- Pranimin në mësimin gjimnazial, shkollën e mesme tregtare, shkollat e mesme profesionale dhe në shkollat e maturës profesionale.

Vendime individuale për karrierën shkollore

Vendime individuale për karrierën shkollore janë parimisht të mundshme gjatë gjithë kohës shkollore dhe gjithashtu gjatë vitit shkollor në vazhdim. Nëse është e nevojshme dhe e arsyeshme ato mund të merren në mënyrë individuale për nxënëse dhe nxënës të vetëm. Nxënëse të vetme dhe nxënës të vetëm mund të ndërrojnë gjatë vitit shkollor p.sh. në një klasë të veçantë ose në shkollën sekondare I në një nivel më të lartë ose të ulët.

Vendime për karrierën shkollore merr drejtorja e shkollës me kërkesë të mësimitdhënësit të klasës. Ato u njoftohen prindërve me shkrim në kuadrin e raportit të vlerësimit ose të një vendimi individual për karrierën shkollore.

Procedura e kalimit nga shkalla primare në shkallën sekondare I

Shkalla primare dhe shkalla sekondare I

- **Shkalla primare** i emërton vitet shkollore 1 deri 6.
- **Shkalla sekondare I** i emërton vitet shkollore 7 deri 9, pavarësisht nga rruga e filluar dhe nga niveli ose tipi shkollor që ndiqet. Në shkallën sekondare I nxënëset dhe nxënësit e vizitojnë ose nivelin e shkollës reale, shkollës sekondare ose të shkollës speciale sekondare (nëse komuna mban një të tillë). Në shkollën sekondare vlejnjë kërkesa më të larta sesa në shkollën reale. Kalimi në shkallën sekondare I bëhet, si rregull, pas vitit të 6-të shkollor.

Procedura e kalimit

Qëllimi i procedurës së kalimit është që fëmija juaj t'i caktohet në bazë të zhvillimit që parashikohet atij tipi shkollor dhe atyre lëndëve të nivelit, në të cilat ai mund të nxitet më mirë. Që procesi i zhvillimit të fëmijës suaj të mund të vëzhgohet dhe të shoqërohet gjatë një faze më të gjatë, koha e vëzhgimit numërohet tashmë që nga viti i pestë shkollor. Vlerësimi i zhvillimit të parashikuar bazohet në:

- vlerësimin e kompetencave lëndore në lëndët gjermanisht, frëngjisht dhe matematikë, ku në mënyrë të veçantë raporti i vlerësimit të vitit të 5-të shkollor dhe raporti i kalimit janë vendimtare.
- vlerësimin e kompetencave personale në të gjitha lëndët;
- vëzhgimet e prindërve;
- vetëvlerësimin e nxënëses ose nxënësit.

Raporti i kalimit

Mësimdhënësi i klasës përpilon një raport kalimi duke përfshirë mësimdhënësit e tjerë që mësojnë në atë klasë. Raporti jep informacion mbi arritjet e nxënësve dhe nxënësve në lëndët gjermanisht, frëngjisht dhe matematikë si dhe në kompetencat në të gjithë lëndët në semestrin e parë të vitit të 6-të shkollor.

Protokolli mbi kalimin

Protokolli mbi kalimin përbëhet nga tre mendime të ndryshme:

- caktimi nga këndvështrimi i mësimdhënësve;
- Vetëvlerësimi i nxënëses/ nxënësit;
- caktimi nga këndvështrimi i prindërve.

Protokolli mbi kalimin shërben si bazë për bisedën mbi kalimin.

Biseda mbi kalimin

Deri në fund të janarit të vitit të 6-të shkollor prindërit e marrin raportin e kalimit dhe protokollin mbi kalimin për të mbajtur qëndrim. Pastaj prindërit dhe nxënësja ose nxënësi ftohen nga mësimdhënësi i klasës për bisedën mbi kalimin. Qëllimi i bisedës mbi kalimin është që të formulohet një kërkesë e përbashkët për caktim. Pas bisedës mësimdhënësi i klasës e plotëson protokollin mbi kalimin me kërkesën përkatëse të drejtuar drejtorisë së shkollës.

Test kontrolli

Nëse nuk arrihet një kërkesë e përbashkët për caktim, atëherë prindërit mund ta regjistrojnë fëmijën e tyre nëpërmjet protokollit mbi kalimin për një test kontrolli kantonal. Nxënëset dhe nxënësit duhet ta bëjnë testin në të gjitha tre lëndët me rëndësi për kalimin, në matematikë, gjermanisht dhe frëngjisht, edhe kur prindërit dhe mësimdhënësi nuk janë të një mendimi vetëm në një lëndë ose në dy lëndë. Drejtorja e shkollës së shkallës primare e merr vendimin mbi kalimin në bazë të rezultateve të testit të kontrollit. Për fëmijë që flasin gjuhë të huaj, të sapoardhur ose të tillë, të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të shkonin në shkollë për një kohë të gjatë ose vuajnë nga një dobësi e të mësuarit, vlejnjë rregulla të veçanta. Mësimdhënës dhe prindër gjejnjë kërkesat e testit si dhe informacione të mëtejshme mbi testin e kontrollit në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim. (www.erz.be.ch)

Vendimi i kalimit

Vendimin e kalimit e merr drejtoria e shkollës në bazë të protokollit mbi kalimin. Kush në të paktën dy prej tre lëndëve relevante për kalimin i caktohet nivelit të shkollës sekondare respektivisht nivelit të veçantë të shkollës sekondare (nëse komuna mban një klasë të veçantë të shkollës sekondare), konsiderohet si nxënëse ose nxënës i tipit përkatës shkollor.

Në kantonin Bernë kalimi në shkallën sekondare I është rregulluar parimisht në mënyrë unike. Për fëmijë që flasin gjuhë të huaj, të sapoardhur ose të tillë, të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të shkonin në shkollë për një kohë të gjatë drejtoria e shkollës mund të mënjanojë nga dispozitat e vlerësimit dhe të procedurës së kalimit.

Dispozitat e promovimit në shkallën sekondare I

Një nxënëse ose një nxënës promovohet për vitin tjetër shkollor, nëse ajo ose ai shfaq në raportin e vlerësimit maksimumi tre nota të pamjaftueshme. Në lëndët gjermanisht, frëngjisht dhe matematikë duhet të ketë maksimalisht një notë të pamjaftueshme. Nëse dispozitat e promovimit nuk përmbushen në fund të vitit shkollor, atëherë bëhet rifutja në kategorinë e tipit më të ulët ose përsëritja e vitit shkollor në të njëjtin tip shkollor.

Një nxënëse ose një nxënës ndërron në tipin më të lartë shkollor, nëse ekziston supozimi i bazuar që ajo ose ai mund t'u mjaftojë kërkesave.

Nxënëset dhe nxënësit e shkollës reale

Nxënëset dhe nxënësit e tipit të shkollës reale mund ta përsërisin vitin e 7-të shkollor, nëse ekziston supozimi i bazuar që ata mund t'u mjaftojnë kërkesave të ngritura.

Nëse nxënëset dhe nxënësit e shkollës reale në fund të vitit shkollor nuk arrijnë një notë të mjaftueshme në shumicën e lëndëve në raportin e vlerësimit, atëherë viti shkollor mund të përsëritet.

Kalimi në shkolla që çojnë më tej të shkollës sekondare II

Për nxënëset dhe nxënësit që dëshirojnë ta vizitojnë gjimnazin ose një shkollë tjetër që çon më tej, vendime për karrierën shkollore bëhen në mes të vitit të 8-të respektivisht të 9-të shkollor. Prindërit informohen nga drejtoria e shkollës dhe mësimmësimit në kohë të përshtatshme në mënyrë të detajuar mbi këto procedura.

Shtojca 1: Notat kanë këtë kuptim

Nota	Arritja e objektivave të mësimit	Zgjidhja e detyrave	Arritja e shkallëve të kompetencave sipas Lehrplan 21
6 shumë mirë	arrin në mënyrë të sigurt objektiva të të mësuarit me kërkesa të larta në shumicën e fushave të kompetencave	zgjedh detyrat me shkallë të ngritur të vështirësisë kryesisht me sukses	Arrin shkallët e kompetencave, të cilat priten në kohën përkatëse ¹ , dhe ka në fusha të veçanta të kompetencave kompetenca që çojnë më tej
5 mirë	arrin objektiva të të mësuarit në të gjitha fushat e kompetencave dhe pjesërisht edhe objektiva të të mësuarit me kërkesa të larta	zgjedh detyrat me shkallë të ngritur të vështirësisë pjesërisht me sukses	arrin shkallët e kompetencave, të cilat priten në kohën përkatëse ¹ , në të gjitha fushat e kompetencave
4 mjaftueshëm	arrin objektiva bazë të të mësuarit në shumicën e fushave të kompetencave	zgjedh detyrat me kërkesat bazë në mënyrë të mjaftueshme	arrin shkallët e kompetencave, të cilat priten në kohën përkatëse ¹ , në shumicën e fushave të kompetencave
3 pamjaftueshëm	nuk arrin objektiva bazë të të mësuarit në shumicën e fushave të kompetencave	zgjedh detyrat me kërkesat bazë në mënyrë të pamjaftueshme	nuk arrin shkallët e kompetencave, të cilat priten në kohën përkatëse ¹ , në disa fusha të kompetencave
2 dobët	nuk arrin objektiva bazë të të mësuarit në shumicën e fushave të kompetencave	nuk zgjedh gati asnjë nga detyrat me kërkesa bazë	nuk arrin shkallët e kompetencave, të cilat priten në kohën përkatëse ¹ , në shumicën e fushave të kompetencave
1 shumë dobët	në të gjitha e fushat e kompetencave nuk i arrin objektiva bazë të të mësuarit	nuk zgjedh asnjë nga detyrat me kërkesa bazë	nuk arrin shkallët e kompetencave, të cilat priten në kohën përkatëse ¹ , në të gjitha fushat e kompetencave

¹ Në fund të vitit të 2-të dhe të 6-të shkollor në shkallën primare dhe në shkallën sekondare I vlen kërkesa bazë.

Shtojca 2: Forma e vlerësimit sipas shkallëve

Apperçu du formulaire (en allemand): ww.erz.be.ch/beurteilung → Downloads

Viti shkollor	Fillimi i vitit shkollor	Mesi i vitit shkollor	Fundi i vitit shkollor		
KG 1	Cikli 1 Kopshti i fëmijëve/Shkalla primare	Biseda me prindërit*		Vendime individuale për karrierën shkollore, kundër të cilave mund të paraqitet ankese, janë të mundshme në të gjithë shkollën popullore.	
KG 2		Biseda me prindërit*			
1.		Biseda me prindërit*			
2.		Biseda me prindërit*	Raporti i vlerësimit pa nota		
3.	Cikli 2 Shkalla primare	Biseda me prindërit*			
4.		Biseda me prindërit*	Raporti i vlerësimit me nota		
5.		Biseda me prindërit*	Raporti i vlerësimit me nota		
6.		Biseda për kalimin** Vendimi për kalimin Shkalla prim./shkalla sek I Raporti/protokolli mbi kalimin eventualisht testi i kontrollit	Raporti i vlerësimit pa nota		
7.	Biseda me prindërit*		Raporti i vlerësimit pa nota		
8.	Cikli 3 Shkalla sekondare I	Biseda me prindërit*	Vendimi për kalimin: Gjimnazi ose shkolla e mesme profesionale	Raporti i vlerësimit me nota	Portfoli kompetenca personale dhe kompetenca kyçe
9.		Biseda me prindërit*	Vendimi për kalimin: Gjimnazi ose shkolla e mesme profesionale	Raporti i vlerësimit me nota Përfundimi i shkollës popullore	

* Çasti i bisedës me prindërit mund të zgjidhet lirisht nga shkollat. Prindërit informohen në kohë mbi çastin.

** Në vitin e 6-të shkollor të shkollës primare zhvillohet biseda për kalimin para mesit të shkurtit.